



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Bazuar ne Nenin 108/A te LPP 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin 04/L-237,
Ligjin Nr. 05/L-68 dhe Ligjin 05/L-092, rregullores mbi Paraqitjen e Kerkeses
per Rishqyrtim pran Autoriteit Kontraktues , Zyra e Prokurimit , date
26.09.2019 merr kete :

Nr.No.Br.

374-40996/19

Data-Date-Datum

26.09.2019

Klinë-Klina

V E N D I M

1. Pranohet Pjeserisht e bazuar , Kërkesa për Rishqyrtim e OE "ARHIKO
ING " NGA PRISHTINA per "Mbi HARTIMI I PROJEKTEVE
ZBATUESE -EKZEKUTIVE , te parashtruar me datën 23.09.2019

2. Pranohet Pjeserisht e bazuar , Kërkesa per Rishqyrtim e O.E "
INFRATEK " nga Prishtina ne Kerkesen per Rishqyrtim te Vendimit per
Dhenje te Kontrates te Postuar ne e-Prokurim me date 24.09.2019

ANULOHET Vendimi i dates 19.09.2019 ,per Propozimin e dhenjes se
kontrates per prokurimin nr. 634-19-502-221 " Hartimi i Projekteve Zbatuese
-Ekzekutive. Dhe Procesi do te RI-VLERESOHET

Arsyetim

O.E ARHIKO ing " nga Prishtina ne Pretendimet e potencuarkonsideron ne
Kërkesën për Rishqyrtim – shekelje ne
Neni 7 i LPP barazia ne Trajtim /Jo diskriminimi .
Neni 59 Ekzaminimi ,Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve .
Neni 65 Kriteret per dhenje te kontrtePranueshmeria e kandidateve ose
tenderueseve
Neni 66 Pershatesheria e Profesionale
Neni 69 Aftesite teknike dhe profesionale

A.K. bazuar ne Vendimin e OSHP date 27.08.2019 me nr. 384/19 dhe
406/19,Ka konsideruar se Gabimet ne Llogaritje Qendrojne dhe se Bazuar ne
ate edhe eshte Pranuar si e tille.

Edhe ne Pretendimin e Ankuesit ARHIKO ING ne ankesen e bere ne OSHP ,
Ne vendimin e OSHP te dates 27.08.2019 me nr. 384/19 dhe 406/19 , ka

Konstatuar se Pretendimi se O.E , Nuk ka plotësuar Kerkesen e AK per stafin ku nuk ka prezantuar Stafin Agronom apo Kimist me Licenc te VMN , por ka prezantuar Biologe. Si dhe Inxhinieri i Ndetimtarise drejtimi konstruktiv gje qe edhe ne kete Vendimi i OSHP , pretendimin e O.E , Arhiko Ing e ka konsideruar te Pa bazuar .

A.K. Duke analizuar kete dhe Gjendjen Faktike dhe Pretendimet dhe Kerkesa per Rishqyrtim e dates 23.09.2019 , O.E ARHIKO ING ka sjelle deshmi qe Pretedimi i tyre se NUK ESHTË GABIM ne Llogaritje meq ne Dosje te tenderit jane kërkuar Vlerat e peshuara , andaj ky vendim QENDRON dhe A.K , gajte Ri-Vleresimit do te analizoj konform LPP .

Edhe per pretendimet e stafit do te kërkojen Mendime dhe kërkesa per Dokumentacion shtese nga O.E dhe te Konstatohet ligjshmëria e Stafit , Ingjinierit e Ndetimtarise dhe Biologes me Liqenc te VMN .

Pretendimi per Shkeljen e pretenduar nen 2, Kerkesa Agronom i diplomuar apo Kimist me Liqenc per VNM , A.K. ka pranuar edhe Inxhiner te bujqesise meqe ka licenc per VNM .

2

Pretendimet e Kerkeses per Rishqyrtim te O.E INFRATEK nga Prishtina te dates 24.09.2019

Neni 60 Kriterret e dhenjes se Kontrates

Neni 7 barazia ne Trajtim /jo diskriminimi

Neni 59 Ekzekutimi , Vlersimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 69 Aftesa Teknike dhe ose Profesionale .

O.E .i propozuar per Kontrtae ka standardet e kërkuara .

Pretendimi nen nr. Rendor 4 . Gabimet ne llogaritje ...

Preendimi i O.E INFRATEK qe konstaton se nuk ka Gabime ne llogaritje , NUK QENDRON , meq vete ne Oferten financiare nuk ka Llogaritur te pozicionet Normen e TVSH qe eshte 18 % por ate 0.18 % , Andaj gjate Kalkulimit eshte konstatuar se Gabimet ne Llogarititje jane me teper se 2 % .

Pretendimi i 2. I O.E ;INFATEK q konsideron se Dokumentacioni i Ingjinierit te O.E per shpërblim me Kontrate nuk jane ne gjuhet zyrtare qe jane ne Kosove , por n Gjuhen Maqenonase , Ky pretendim QENDRON dhe gjate Ri

vlerësimit duke u bazuar ne LPP dhe përdorimi i gjuhëve do te kërkojen Sqarime shtese .

Pretendimi i O.E . INFRATEK , per licencat e O.E te propozuar per dhenje te kontrates , jane te skaduara , edhe Ky pretendim QENDRON dhe gjate Ri-Vleresimit do te Verifikohen .


Bazuar ne ate se Disa nga Pretendimet qendrojne A.K. vendos qe Procesi te shkoj ne RI- VLERESIM .

Keshilla Juridike :

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka te drejte ankese ne OSHP konform Nenit 109 te LPP .

Zyra e Prokurimit

z. Abaz Foniqi

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text "KOMUNA E KISHINEV" at the top, "MUNICIPALITY OF KISHINEV" at the bottom, and "PROCURATOR GENERAL" in the center. There is also some smaller text in the center that is partially obscured by the signature.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenet 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: (KUVENDI KOMUNAL I KLINËS)

Për Aktivitetin e Prokurimit: (634-19-502-2-2-1)

Sa i përket tenderit për (HARTIMI I PROJEKTEVE ZBATUESE -EKZEKUTIVE)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Arhiko.ing OP

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

B.Dielli, Z. Lindles A11/13, Prishtine

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10 000

(Kodi postar)

+383 44 117 624

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Shefshet Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

arhiko.ing@gmail.com

(Adresa elektronike)

23.09.2019

(Data e parashtrimit të kërkesës)

Arhiko



(Nënshkrimi dhe vulë)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontrate: 25.02.2019

Informacion shtese 28.02.2019

Afati për dorëzimin e tenderit: 20.03.2019

Vendimi për shpërblim me kontratë: 26.04.2019

Vendimi për pezullim me datë 03.05.2019

Vendimi për rezultat të rrvleresimit: 26.06.2019

Vazhdimi sigurimit të tenderit - hartimi i projekteve zbatuese 04.09.2019

Vendim për shpërblim me kontratë - projektet zbatuese - ri vleresim 19. 09.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja është dërguar në mënyrë elektronike, nuk kemi asnjë vërejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 13 i LPP: Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

Neni 59 i LPP: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK ka bërë shkelje ligjore që na ka eliminuar me vendime të padrejta dhe ka shpallur fituese kompaninë e papërgjegjshme dhe me çmimin shumë më të lartë në këtë ofertë.

1. JANE GJETUR GABIME ARETHMETIKORE MBI VLEREN ELEJUAR PREJ 2%.
Vlera e lexuar (Njesi) 0.631 € e llogaritur nga paramasat (njesi) 1.96 euro

AK ka bërë shkelje (devijim) të dosjes së tenderit edhe në fazën kur ne jemi shpall fitues 26.04.2019 në B58, ka vendosur çmimet e papesuara dhe nuk i ka përfill kriterin për vendosjen e çmimit të ofertuar në hapje të tenderëve apo çmimet siç i ka kërkuar në dosjen e tenderit, siç shihet në faqen 21,33 dhe 58 të paramasa, ku kriter ka qenë që çmimi në hapje dhe çmimi vlerësues duhet të jetë çmimi i peshuar.

Andaj neve na është bërë vlerësimi në të kundërtën e asaj që është në dosjen e tenderit dhe ka kërkuar AK, kurse kompanisë që ka shpallur fitues në këtë fazë e ka vlerësuar të përgjegjshme në këtë pikë ku shihet të dosja në faqen 21,33 dhe 58 të paramasa dhe me poshtë po e ngarkojmë kriterin e vendosur në paramasë se çka ka kërkuar AK.

Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlere). Kjo është vlera e cila do të duhet të shenohet në Formularin e ofertes dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.

Duke u bazuar edhe në vendimin e OSHP të datës 27.08.2019 ku i terheq vërejtje AK se. Pra, bazuar në keto sqarime të paraqitura me lartë rezulton se ka mos-perputhje të ofertes së OE "Arhiko.Ing" ka shënuar në formularin C - 0.65 €, dhe të tabela e EXCELIT (që duhet të jetë Totali i vlerës i paraqitur në këto tabela). Pra, duke u bazuar në nenin 39.8 të RrUOPP dallimi i vlerës tejkalon vlerën e lejuar +/-2%. Pra, bazuar në pretendimin ankimor të OE ankues mendojmë se OE "Arhiko.Ing" nuk e ka plotësuar siç duhet tabelën por e ka vendosur çmimin e poentuar. Pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar. **AK duhet të ketë parasysh dhe të trajtohen gjithë OE sipas kriterëve të kërkuara në Njoftim për kontratë dhe FDT sipas nenit 7, nenit 59.** AK duhet të marrë parasysh Njoftimin e OSHP-së, nr.212/19, ashtu siç është pajtuar me raportin e ekspertizës nr.212/19, në të kundërtën përgjegjësia ligjore bie mbi zyrtarin përgjegjës të prokurimit.

ROUPP thote:

28.14 Funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave.

Gjat fazes së plotsimit të formularit me qmime të peshuara paramasa në Exel i ka fiksuar qmimet dhe ka bërë ndryshimin e qmimeve nga 0.631 € e ka fiksuar qmimin 0.65 €, ku qmimi i peshuara kanë ulur qmimet njësi dhe ka ardhur deri të ky ndryshim në plotsim të formularit Exel.

Arsyetimi i dytë që nuk kemi ofruar inxhinier Agronom apo Kimist por të biologjise nuk qendron sepse në dosje ju keni specifikuar që inxhinieri duhet të jetë i licencuar për raport të VNM dhe është kërkuar që për këtë inxhinier të ketë vetëm licencën e noterizuar e jo diploma ose kualifikimi universitar. Kjo le të kuptohet që AK nuk i ka interesuar kualifikimi por licenca e VNM për punët e kërkuara në paramas, pasi që Agronomi apo Kimisti janë dy profesione të ndryshme që dallojnë shumë në kualifikimin profesional. Poashtu kimisti dhe biologu janë të dyja degë të FSHMN-së. Në punët që parashihen është e domosdoshme raporti i VNM dhe kjo nuk ka rëndësi se a është kimist apo biolog me rëndësi ka kualifikimin e nevojshëm për përpilimin e raporteve të VNM. Me eliminimin tonë AK ka bërë shkelje të nenin 59 paragrafi 4 ku thuhet:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Duke u bazuar edhe në vendimin e OSHP të datës 27.08.2019 ku thot.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit konstaton se ky pretendim është i pleserisht i bazuar pasi që kërkesa e AK-së ka qenë: "Një agronom i diplomuar apo kimist". Për agronomin apo kimistin edhe licenca për Ndikim të mjedisit (VNM). (Bachelor ose master). Licenca duhet të jetë e noterizuar" dhe OE ankues lidhur me këto kriter ka prezantuar: Luljeta Aidini e cila me profesion është biologe, por është e licencuar për NVM, pra kriteri i kërkuar i AK ka qenë agronom apo Kimist.

Në rastin konkret dosja jone përmban vetëm një devijim të vogël që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime në karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e parashtruara nga AK. AK duhet të ketë edhe anën ekonomike të ruajtjes së buxhetit të qytetareve pasi që për devijime të vogla që edhe ligji i jep të drejtë që të ketë kursimin të mirë dhe të kryej punët sipas planifikimeve. Kjo len të kuptoj se AK nuk e ka përfill fare ligjet dhe të kursej buxhetin e vet.

Rrjedhimisht AK ka bërë shkelje të nenit 59, nenit 65 dhe nenit 69 të LPP.

Rrjedhimisht nga kjo që u tha me lartë në kërkojmë nga AK që të rishqyrtoj vendimin dhe të na shpallë fitues pasi që ofrojmë çmimin dukshëm më të ulët se kompaninë e shpallur fituese dhe me çmimin shumë më të lartë në këtë ofertë.

VEREJTJET PËR KOMPANIJA E SHPALLUR FITUESE ME DATEN 19.09.2019

1. Devijimi i parë është paramasa e dorëzuar në formatin PDF e jo në formatin siç është kërkuar në FTD në formatin Excel.
2. Çmimi i ngarkuar për hapjen e tenderëve ka qenë qmim i papeshuar e jo si në dosjen e tenderit ku thotë qart se: **Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vleresohen në baze të kësaj vlere). Kjo është vlere e cila do të duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.**
3. Staf i prezantuar ka diplomë në gjuhët jo zyrtare në gjuhën Boshnjake kur dihet qart se qdo dokument i dorëzuar duhet të ketë tri gjuhë zyrtare.
4. Te pajisjet dhe stabilimentet Kërkesa 3. Mungon GPS, Dron. Kompania në fjalë ka ofruar pajisje e cila nuk i përgjigjet kërkesave të FTD, ka ofruar pajisjen fotografike : 4 K video resolution, 30 m sensor range, '1 Photo Sensor. E jo siç e kërkon dosja e tenderit GPS, Dron.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia e marrjes së punës

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.